



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 171

Tiranë – E mërkurë, 22 nëntor 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 82/2023, datë 2.11.2023	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 18.10.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”..... 20945
Dekret i Presidentit nr. 330, datë 20.11.2023	Për shpallje ligji..... 20945
Ligj nr. 87/2023, datë 2.11.2023	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë, nga njëra anë, dhe Bashkimit Europian, nga ana tjetër, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit “Europa Digjitale” (2021–2027)..... 20945
Dekret i Presidentit nr. 331, datë 20.11.2023	Për shpallje ligji..... 20954
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 652, datë 22.11.2023	Për caktimin e ditës së hënë, datë 27.11.2023, ditë pushimi..... 20954
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar nr. 350, datë 16.11.2023	Për delegim të përkohshëm të kompetencave..... 20954
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 17240, datë 17.11.2023	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare..... 20955
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 17.10.2023	Çështja Prodhim Veshje nr. 2 sh.a. kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 34649/14</i>)..... 20955

Vendim i Gjykatës Kushtetuese
nr. 1 (Nj) 2023 i regjistrit
themeltar, datë 14.11.2023

Me objekt shfuqizimin e nenit 4, pikat 1, shkronja “c”, 2, shkronja
“b” dhe 3, shkronja “b”, si dhe i nenit 5, fjalia e parë, të ligjit nr.
60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin
programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e
Përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë”, si të
papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Pezullimin e ligjit nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve
që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi
e Përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë” deri në
hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.....

20958

Vendim i Gjykatës Kushtetuese
nr 50, datë 18.10.2023

Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 569, datë 25.2.2014, të
Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-2177, datë 5.10.2022, të
Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me
Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....

20960

**LIGJ**
Nr. 82/2023**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 5,
DATË 18.10.2023, “PËR DISA SHTESA
DHE NDRYSHIME NË LIGJIN
NR. 84/2022, ‘PËR BUXHETIN
E VITIT 2023’”**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 18.10.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/2022, Për buxhetin e vitit 2023”.

Miratur në datën 2.11.2023.

Shpallur me dekretin nr. 330, datë 20.11.2023,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 330, datë 20.11.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 82/2023, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 18.10.2023, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/2022, Për buxhetin e vitit 2023”.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 87/2023**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES**
NDËRKOMBËTARE NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NGA
NJËRA ANË, DHE BASHKIMIT
EUROPIAN, NGA ANA TJETËR, PËR
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E
BASHKIMIT “EUROPA DIGJITALE”
(2021–2027)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë, nga njëra anë, dhe Bashkimit Europian, nga ana tjetër, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit “Europa Digjitale” (2021–2027) sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 2.11.2023.

Shpallur me dekretin nr. 331, datë 20.11.2023
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj



MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE
NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN, NGA
NJËRA ANË, DHE REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, NGA ANA TJETËR, PËR
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E
BASHKIMIT “EUROPA DIGJITALE”
(2021–2027)

Komisioni Evropian (në vijim i referuar si “Komisioni”), në emër të Bashkimit Evropian, nga njëra anë,
dhe
Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në emër të Republikës së Shqipërisë (në vijim e referuar si “Shqipëria”), nga ana tjetër,

në vijim të referuara si “Palët”

duke pasur parasysh se Marrëveshja Kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Programet e Komunitetit (në vijim e referuar si “Marrëveshja Kuadër”)¹ përcakton që termat dhe kushtet specifike, duke përfshirë kontributin financiar në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në një program të tillë, do të përcaktohen me një memorandum mirëkuptimi² ndërmjet Komisionit, që vepron në emër të Komunitetit dhe qeverisë së Shqipërisë.

duke pasur parasysh programi i Bashkimit Evropian, Programi i Europës Digjitale u krijua me Rregulloren (BE) 2021/694 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (në vijim e referuar si “Rregullorja (BE) 2021/694”)³;

duke pasur parasysh se termat dhe kushtet specifike të asocimit duhet të përcaktohen nga një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Bashkimit Evropian dhe vendit të asociuar;

duke njohur parimet e përgjithshme siç përcaktohen në Rregulloren (BE) 2021/694;

duke marrë parasysh përpjekjet e Bashkimit Evropian për të udhëhequr reagimin duke bashkuar forcat me partnerët e tij ndërkombëtarë për të adresuar sfidat globale në përputhje me planin e

veprimit për njerëzit, planetin dhe prosperitetin në Agjendën e Kombeve të Bashkuara “Transformimi i botës sonë: Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm”, dhe duke theksuar se transformimi digjital i ekonomisë dhe shoqërisë sonë ofron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillim dhe vende pune, mund të kontribuojë në tranzicionin e gjelbër dhe konkurrencën tonë globale, dhe mund të rritë diversitetin krijues dhe kulturor;

duke theksuar nevojën për një tranzicion digjital të drejtë dhe të qëndrueshëm të njeriut në lidhje me vendosjen e teknologjive të reja digjitale në ekonomi dhe shoqëri, duke kërkuar të forcojë mbështetjen e tij publike;

duke njohur rolin thelbësor mundësues, për tranzicionet binjake dhe udhëheqjen digjitale të Bashkimit, të infrastrukturave digjitale në fushat e Kompjuterave me performancë të lartë; inteligjencës artificiale, përpunimin e të dhënave në “Cloud” dhe hapësirat e të dhënave; dhe sigurinë kibernetike;

duke njohur nevojën për të zhvilluar aftësi të avancuara digjitale për të operuar dhe përdorur në mënyrë optimale kapacitetet e ardhshme digjitale, si dhe për të udhëhequr transformimin digjital të bizneseve dhe shërbimeve publike në të gjithë sektorët e ekonomisë;

duke theksuar rolin kryesor në zbatimin e Programit të Europës Digjitale që i atribuohet rrejtit të qendrave evropiane të inovacionit digjital, që do të veprojnë si lehtësuese për të bërë bashkë industrinë, bizneset dhe administratat publike që kanë nevojë për zgjidhje të reja teknologjike, me bizneset, në veçanti sipërmarrjet fillestare dhe SME-të që kanë zgjidhje digjitale të gatshme për tregun në Shtetet Anëtare dhe vendet partnere pjesëmarrëse;

duke pranuar se zhvillime të tilla transformuese kërkojnë të punohet me partnerët ndërkombëtarë të Bashkimit në transparencën më maksimale bazuar në qëllimet dhe vlerat e përbashkëta ndërsa mbrohen interesat e sigurisë së Bashkimit;

duke kërkuar krijimin e një bashkëpunimi reciprok në mënyrë që të forcohet dhe mbështetet vendosja e kapaciteteve digjitale të besueshme dhe të sigurta në Bashkim në kompjuterat me

¹ OJ L 192, 22.7.2005, f. 2

² Kjo Marrëveshje Ndërkombëtare përbën dhe ka të njëjtat efekte juridike si një memorandum mirëkuptimi i deklaruar sipas Marrëveshjes Kuadër për termat dhe kushtet për pjesëmarrjen në programet e Komunitetit.

Faqe | 20946

³ Rregullorja (BE) 2021/694 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 29 prill 2021, për krijimin e Programit të Europës Digjitale dhe shfuqizimin e vendimit (BE) 2015/2240 (tekst me rëndësi për ZEE-në) (OJ L 166, 11.5.2021, f. 1–34).



performancë të lartë; intelijenca artificiale, përpunimin e të dhënave në “Cloud” dhe hapësirat e të dhënave; siguria kibernetike; aftësi të avancuara digjitale; dhe aplikimin dhe përdorimi më i mirë i kapaciteteve dhe ndërveprueshmërisë digjitale, dhe duke lehtësuar marrjen, si dhe shfrytëzimin dhe aksesueshmërinë e zgjidhjeve digjitale me Palët;

duke njohur se pjesëmarrja reciproke në programet e njëri-tjetrit për zhvillimet digjitale duhet të sigurojë përfitime të ndërsjella për Palët duke garantuar një nivel të lartë të mbrojtjes së drejtave themelore (duke përfshirë mbrojtjen e të dhënave dhe të drejtat digjitale), si dhe standardet etike dhe duke pranuar se Palët rezervojnë të drejtën e tyre për të kufizuar ose kushtëzuar pjesëmarrjen në veprime të caktuara në bazë të arsyeve të justifikuara të sigurisë;

duke njohur rëndësinë e sigurimit të rritjes së elasticitetit të furnizuesit digjital dhe ofrimit të zgjidhjeve globale për Palët;

duke marrë parasysh qëllimet, vlerat e përbashkëta dhe lidhjet e forta të palëve në fushën e teknologjive digjitale dhe duke njohur dëshirën e përbashkët të Palëve për të zhvilluar, forcuar, stimuluar dhe zgjeruar më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin midis tyre;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i asocimit

1. Shqipëria do të marrë pjesë si një vend i asociuar dhe do të kontribuojë në objektivat specifike (OS) 1 (Kompjuterat me performancë të lartë (HPC)), 2 (Intelijenca artificiale), 4 (Aftësi digjitale të avancuara) dhe 5 (Aplikimi dhe përdorimi sa më i mirë i kapaciteteve digjitale dhe ndërveprueshmërisë) të Programit të Europës Digjitale, të referuar në nenin 3 të Rregullores (BE) 2021/694, në versionin e saj më të përditësuar.

Neni 2

Termat dhe kushtet e pjesëmarrjes në Programin e Europës Digjitale

1. Shqipëria do të marrë pjesë në Programin e Europës Digjitale në përputhje me kushtet e

përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër, dhe sipas termave dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, në aktin ligjor të përmendur në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe në çdo rregull tjetër që lidhet me zbatimin e Programit të Europës Digjitale, në versionin e tyre më të përditësuar.

2. Nëse nuk parashikohet ndryshe në termat dhe kushtet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, duke përfshirë zbatimin e nenit 12, pika 6 të Rregullores (BE) 2021/694, personat juridikë të vendosur në Shqipëri mund të marrin pjesë në veprimet e Programit të Europës Digjitale në kushte të barabarta me ato të zbatueshme për personat juridikë të krijuar në Bashkimin Evropian, duke përfshirë respektimin e masave kufizuese të Bashkimit Evropian⁴.

3. Përpara se të vendosë nëse personat juridikë të vendosura në Shqipëri kanë të drejtë të marrin pjesë në një veprim që lidhet me sigurinë e Bashkimit Evropian sipas nenit 12(6) të Rregullores (BE) 2021/694, Komisioni mund të kërkojë informacion specifik ose garanci, të tillë si:

a) informacion nëse u është dhënë ose do t'u jepet akses reciprok personave juridikë të krijuar në Bashkimin Evropian në programet, projektet, veprimet ose aktivitetet ekzistuese dhe të planifikuara të Shqipërisë, të barasvlershme me veprimin e Europës Digjitale në fjalë,

b) informacion nëse Shqipëria ka një mekanizëm kombëtar të shqyrtimit të investimeve dhe garancitë që autoritetet shqiptare do të raportojnë dhe konsultojnë Komisionin për çdo rast të mundshëm kur, në zbatimin e një mekanizmi të tillë, ata kanë marrë dijeni për investime të huaja të planifikuara/marra përsipër nga një subjekt i krijuar ose i kontrolluar nga jashtë Shqipërisë të një personi juridik shqiptar, e cila ka marrë financim nga Programi i Europës Digjitale në veprimet që lidhen me sigurinë e Bashkimit Evropian, me kusht që Komisioni të furnizojë Shqipërinë me listën e personave juridikë përkatës të krijuar në Shqipëri pas nënshkrimit të marrëveshjeve të grantit me këto subjekte; dhe

c) garanton se asnjë nga rezultatet, teknologjitë, shërbimet dhe produktet e zhvilluara në kuadër të veprimeve përkatëse nga subjektet e krijuara në

⁴ Masat kufizuese të BE-së miratohen në bazë të Traktatit për Bashkimin Evropian ose të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.



Shqipëri nuk do t'i nënshtrohet kufizimeve në eksportin e tyre drejt Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian gjatë aksionit dhe për katër vjet pas përfundimit të aksionit. Shqipëria do të ndajë një listë të përditësuar të subjekteve të kufizimeve kombëtare të eksporteve në baza vjetore, gjatë aksionit dhe për katër vjet pas përfundimit të aksionit.

4. Aty ku kushtet e thirrjes kufizojnë pjesëmarrjen në një veprim për shkak të konsideratave në lidhje me sigurinë e Bashkimit sipas nenit 12(6) të Rregullores (BE) 2021/694, Komisioni mund të kërkojë nga Shqipëria informacion ose garanci specifike në mënyrë që të vlerësojë përmbushjen e garancive të dhëna nga subjektet përkatëse që pjesëmarrja e tyre në aksion nuk do të ndikonte negativisht në sigurinë e Bashkimit.

5. Kur Bashkimi Evropian zbaton Programin e Europës Digjitale mbështetur në nenet 185 dhe 187 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, Shqipëria dhe personat juridikë shqiptarë mund të marrin pjesë në strukturat ligjore të krijuara sipas atyre dispozitave, në përputhje me aktet ligjore të Bashkimit Evropian që janë miratuar ose do të miratohen për krijimin e atyre strukturave ligjore.

6. Shqipëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme, sipas rastit, për të siguruar që mallrat dhe shërbimet, të blera në Shqipëri ose të importuara në Shqipëri, të cilat financohen pjesërisht ose plotësisht në përputhje me marrëveshjet e grantit dhe/ose kontratat e lidhura për realizimin e aktiviteteve në përputhje me këtë Marrëveshje, përjashtohen nga detyrimet doganore, detyrimet e importit dhe pagesa të tjera fiskale që janë të zbatueshme në Shqipëri, përfshirë TVSH-në.

7. Përfaqësuesit e Shqipërisë do të kenë të drejtë të marrin pjesë si vëzhgues në komitetin e përmendur në nenin 31 të Rregullores (BE) 2021/694, pa të drejtë vote dhe për pikat që kanë të bëjnë me Shqipërinë. Ata nuk do të kenë të drejtë të marrin pjesë në aktivitete sipas OS me të cilat ata nuk janë të lidhur.

8. Shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet për jetesën të kryera nga përfaqësuesit dhe ekspertët e shqiptarë për pjesëmarrje si vëzhgues në punën e komisionit të referuar në nenin 31 të Rregullores 2021/694, ose në takime të tjera që lidhen me zbatimin e Programit të Europës Digjitale, do të rimbursohen nga Bashkimi Evropian sipas

rregullave të njëjta dhe në përputhje me procedurat në fuqi për përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.

Neni 3

Kontributi financiar

1. Pjesëmarrja e Shqipërisë ose e personave juridikë shqiptarë në Programin e Europës Digjitale do të jetë objekt i kontributit financiar të Shqipërisë në Program dhe kostot përkatëse të menaxhimit, ekzekutimit dhe funksionimit nën buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian (në vijim i referuar si "Buxheti i Bashkimit").

2. Kontributi financiar do të marrë formën e shumës, së:

- a) një kontributi operacional; dhe
- b) një tarife pjesëmarrjeje.

3. Kontributi financiar do të marrë formën e një pagese vjetore të bërë në dy këste dhe do të paguhet jo më së vonë se muajt maj dhe korrik.

4. Kontributi operacional do të mbulojë shpenzimet operative dhe mbështetëse të Programit dhe do të jetë shtesë, si në shumat e përcaktuara si angazhime buxhetore ashtu edhe si pagesa të shumave të përfshira në buxhetin e Bashkimit të miratuara përfundimisht për Programin e Europës Digjitale.

5. Kontributi fillestar operativ do të bazohet në një kontributi kryesor të përcaktuar si raporti i Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) të Shqipërisë me çmimet e tregut ndaj PBB-së së Bashkimit Evropian sipas çmimeve të tregut. PBB-ja në çmimet e tregut që do të aplikohet, do të përcaktohet nga shërbimet e dedikuara të Komisionit bazuar në të dhënat më të fundit statistikore të disponueshme për llogaritjet e buxhetit në vitin paraardhës të vitit kur duhet kryer pagesa vjetore.

Rregullimet për këtë kontribut kryesor janë përcaktuar në shtojcën I.

6. Kontributi fillestar operacional do të llogaritet duke përdorur kontributin kryesor, të rregulluar, në shumat fillestare të angazhimeve të autorizuara si angazhime buxhetore, pjesë të buxhetit të Bashkimit të miratuara përfundimisht për vitin e caktuar për financimin e Programit të Europës Digjitale.

7. Tarifa e pjesëmarrjes do të jetë 4% e kontributit fillestar operativ vjetor siç llogaritet në përputhje me paragrafët 5 dhe 6 të këtij neni dhe do të ndahet në faza siç përcaktohet në shtojcën I.



Tarifa e pjesëmarrjes nuk do t'i nënshtrohet rregullimeve ose korigjimeve prapavepruese.

8. Bashkimi Evropian do t'i japë Shqipërisë informacion në lidhje me pjesëmarrjen e saj financiare, siç përfshihet në informacionin buxhetor, kontabël, performancën dhe vlerësimin e dhënë autoriteteve buxhetore dhe zbatuese të Bashkimit Evropian në lidhje me Programin e Europës Digjitale. Ky informacion do të jepet duke respektuar rregullat e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë dhe nuk do të cenojë informacionin që Shqipëria ka të drejtë të marrë sipas shtojcës III.

9. Të gjitha kontributet e Shqipërisë ose pagesat nga Bashkimi Evropian, dhe llogaritja e shumave që duhen paguar ose që do të merren, do të bëhen në euro.

Neni 4 Reciprociteti

1. Personat juridikë të vendosur në Bashkimin Evropian mund të marrin pjesë në programe, projekte, veprime dhe aktivitete ose pjesë të tyre, të barasvlershme të Shqipërisë me Programin e Europës Digjitale, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

2. Lista joshteruese e programeve, projekteve, veprimeve dhe aktiviteteve ekuivalente të Shqipërisë ose pjesë e tyre paraqitet në shtojcën II.

3. Financimi nga Shqipëria i personave juridikë të vendosur në Bashkimin Evropian do t'i nënshtrohet legjislacionit të Shqipërisë që rregullon funksionimin e programeve, projekteve, veprimeve dhe aktiviteteve ose pjesë të tyre. Në rast se nuk sigurohet financimi, personat juridikë të vendosur në Bashkimin Evropian mund të marrin pjesë me mjetet e tyre.

Neni 5 Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

1. Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit, Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (ZEKM) dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e Programit të Europës Digjitale, pjesëmarrja e Shqipërisë në atë Program do të monitorohet vazhdimisht mbi një bazë partneriteti duke përfshirë Komisionin dhe Shqipërinë.

2. Rregullat për menaxhimin e qëndrueshëm financiar, duke përfshirë kontrollin financiar, rikuperimin dhe masat e tjera kundër mashtrimit në lidhje me financimin e Bashkimit Evropian sipas kësaj Marrëveshjeje janë përcaktuar në shtojcën III.

Neni 6 Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme, të nevojshme për këtë qëllim.

2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet nga data 1 janar 2023. Ajo do të mbetet në fuqi për aq kohë sa është e nevojshme për të gjitha projektet, veprimet, aktivitetet ose pjesët e tyre të financuara nga Programi i Europës Digjitale, të gjitha veprimet e nevojshme për të mbrojtur interesat financiare të Bashkimit Evropian dhe të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje ndërmjet Palëve të përmbushen.

3. Bashkimi Evropian dhe Shqipëria mund ta zbatojnë këtë Marrëveshje përkohësisht në përputhje me procedurat dhe legjislacionin e tyre të brendshëm përkatës. Zbatimi i përkohshëm do të fillojë në datën në të cilën Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për këtë qëllim.

4. Nëse Shqipëria njofton Komisionin që vepron në emër të Bashkimit Evropian se nuk do të përfundojë procedurat e brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje nuk do të zbatohet përkohësisht në datën e marrjes së këtij njoftimi nga Komisioni, e cila do të përbëjë datën e ndërprerjes për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

5. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje mund të pezullohet nga Bashkimi Evropian në rast të mospagesës nga Shqipëria të kontributit financiar ose operativ të detyrueshëm në përputhje me paragrafin 3 të pikës II të shtojcës I.

Pezullimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do t'i njoftohet Shqipërisë nga Komisioni Evropian me një letër njoftimi zyrtar, e cila do të hyjë në fuqi 15 ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga Shqipëria.

Në rast se zbatimi i kësaj Marrëveshjeje pezullohet, personat juridikë të vendosur në Shqipëri nuk do të kenë të drejtë të marrin pjesë në procedurat e papërfunduara të dhënies së kontratave



kur pezullimi të hyjë në fuqi. Procedura e dhënies së kontratës do të konsiderohet e përfunduar me zbatimin e angazhimeve ligjore si rezultat i kësaj procedure.

Pezullimi nuk prek angazhimet ligjore të lidhura me personat juridikë të vendosur në Shqipëri përpara hyrjes në fuqi të pezullimit. Kjo Marrëveshje do të vazhdojë të zbatohet për këto angazhime ligjore.

Bashkimi Evropian do të njoftojë menjëherë Shqipërinë me marrjen e gjithë shumës së kontributit financiar që ajo i detyrohet Bashkimit Evropian. Pezullimi do të hiqet me efekt të menjëhershëm pas këtij njoftimi.

Që nga data e heqjes së pezullimit, personat juridikë të Shqipërisë do të gëzojnë përsëri të drejtën për të marrë pjesë në procedurat e dhënies së kontratës/ave të lançuara pas kësaj date dhe në procedurat e dhënies së kontratës të lançuara përpara kësaj date, për të cilat nuk kanë skaduar afatet për paraqitjen e aplikimeve.

6. Secila palë mund ta zgjidh këtë Marrëveshje në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim që informon për qëllimin e saj për ta zgjidhur atë. Zgjidhja do të hyjë në fuqi tre muaj kalendarik pas datës në të cilën njoftimi me shkrim i arrin adresuesit. Data kur zgjidhja hyn në fuqi, do të përbëjë datën e zgjidhjes për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

7. Kur kjo Marrëveshje nuk zbatohet përkohësisht në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni ose zgjidhet në përputhje me paragrafin 6 të këtij neni, Palët bien dakord, që:

a) projektet, veprimet dhe aktivitetet ose pjesët e tyre për të cilat janë marrë angazhime ligjore gjatë zbatimit të përkohshëm dhe/ose pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, dhe përpara se kjo Marrëveshje të pushojë së zbatuari ose të zgjidhet do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

b) kontributi financiar vjetor i vitit gjatë të cilit kjo Marrëveshje nuk zbatohet përkohësisht ose zgjidhet, do të paguhet tërësisht në përputhje me nenin 3.

Palët do të zgjidhin me pëlqim të ndërsjellë çdo pasojë tjetër të zgjidhjes ose ndërprerjes së zbatimit të përkohshëm të kësaj Marrëveshjeje.

8. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve. Hyrja në fuqi e ndryshimeve do të ndjekë të njëjtën

procedurë si ajo që zbatohet për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

9. Shtojcat e kësaj Marrëveshjeje do të jenë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje do të hartohet në dy kopje në gjuhën angleze dhe shqipe, ku secili tekst është i barasvlershëm. Në rast të divergjencave në përkthim, do të prevalojë teksti në gjuhën angleze.

Bërë në Bruksel, më datë 12.7.2023.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Belinda Balluku

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË

PËR BASHKIMIN EVROPIAN

Thierry Breton

KOMISIONER PËR TREGUN E
BRENDSHËM

17.8.2023

Shtojca I: Rregullat që rregullojnë kontributin financiar të Shqipërisë në Programin e Europës Digjitale (2021-2027).

Shtojca II: Lista jo shteruese e programeve, projekteve, veprimeve, aktiviteteve ose pjesëve të tyre ekuivalente të Shqipërisë

Shtojca III: Menaxhimi i qëndrueshëm financiar

SHTOJCA I

RREGULLAT QË RREGULLOJNË
KONTRIBUTIN FINANCIAR TË
SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E
EUROPËS DIGJITALE (2021–2027)

I. Llogaritja e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Kontributi financiar i Shqipërisë në Programin e Europës Digjitale do të përcaktohet në bazë vjetore në raport me shumën e disponueshme çdo vit në buxhetin e Bashkimit për shumat e autorizuar si angazhime buxhetore të nevojshme për menaxhimin, ekzekutimin dhe funksionimin e Programit të Europës Digjitale.

2. Tarifa e pjesëmarrjes e përmendur në nenin 3, pika 7 të kësaj Marrëveshjeje do të kalojë në fazat e mëposhtme:

- 2023: 1.5%;
- 2024: 2%;
- 2025: 2,5%;



- 2026: 3%;
- 2027: 4%.

Në përputhje me nenin 3, pika 5, të kësaj Marrëveshjeje, kontributi fillestar operacional që do të paguhet nga Shqipëria për pjesëmarrjen e saj në Programin e Europës Digjitale, do të llogaritet për vitet financiare përkatëse duke aplikuar një rregullim për kontributin kryesor.

Rregullimi i kontributit kyç/kryesor do të jetë:

Rregullimi i kontributit kyç/kryesor = kontributit kyç/kryesor $\times$ Koeficienti

Koeficienti i përdorur për llogaritjen e mësipërme për rregullimin e kontributit do të jetë 0.5.

II. Pagesa e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Komisioni do t'i komunikojë Shqipërisë, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo me vonë se dita kur nxjerr thirrjen e parë për fonde të vitit financiar, informacionin e mëposhtëm:

a) shumat në angazhimet e autorizuara në buxhetin e Bashkimit të miratuara përfundimisht për vitin në fjalë për linjat buxhetore që mbulojnë pjesëmarrjen e Shqipërisë, në Programin e Europës Digjitale;

b) shuma e tarifës së pjesëmarrjes e përmendur në nenin 3, pika 7 të kësaj Marrëveshjeje;

Në bazë të projektbuxhetit të tij, Komisioni do të sigurojë një vlerësim të informacionit për vitin pasardhës sipas pikave (a) dhe (b) sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë se 1 shtatori i vitit financiar.

2. Komisioni do të nxjerrë, jo më vonë se muaji prill dhe qershor të çdo viti financiar, një thirrje për fonde për Shqipërinë që përkon me kontributin e saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

Thirrja për fonde do të parashikojë pagesën e kontributit të Shqipërisë jo më vonë se 60 ditë pas shpalljes së thirrjes për fonde.

3. Shqipëria do të paguajë kontributin e saj financiar sipas kësaj Marrëveshjeje në përputhje me pikën (II) të kësaj shtojce. Në mungesë të pagesës nga Shqipëria deri në datën e caktuar, Komisioni do të dërgojë një letër zyrtare kujtese.

Çdo vonesë në pagesën e kontributit financiar do të shkaktojë pagesën e kamatëvonesës nga Shqipëria, për shumën e papaguar që nga data e caktuar.

Norma e interesit për shumat e arkëtueshme që nuk janë paguar në datën e caktuar do të jetë norma e aplikuar nga Banka Qendrore Evropiane për

operacionet e saj kryesore të rifinancimit, siç është botuar në vëllimin C të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Evropian në fuqi, në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin bie data e caktuar për pagesën, rritur me vlerën tre pikë e gjysmë përqindje.

Në rast se vonesa në pagesën e kontributit është e tillë që mund të rrezikojë ndjeshëm zbatimin dhe menaxhimin e Programit të Europës Digjitale, pjesëmarrja e Shqipërisë në Programin e Europës Digjitale do të pezullohet nga Komisioni pas 20 ditësh pune mungesë pagese, pasi është dërguar një letër kujtese formale, pa cënuar detyrimet e Bashkimit sipas marrëveshjeve të granteve dhe/ose kontratave të lidhura tashmë në lidhje me zbatimin e veprimeve indirekte për të cilat është përzgjedhur Shqipëria.

Shtojca II

Lista e programeve, projekteve, veprimeve, aktiviteteve ekuivalente ose pjesë të saj të Shqipërisë

Lista e mëposhtme jo shteruese do të njihet si lista me programe, projekte, veprime dhe aktivitete shqiptare të barasvlershme me Programin e Europës Digjitale:

- Programi Kombëtar i Kërkimit dhe Zhvillimit

Shtojca III

Menaxhimi i qëndrueshëm financiar

Seksioni 1. Mbrojtja e interesave financiare dhe rikuperimi

Neni 1

Shqyrtime dhe auditime

1. Bashkimi Evropian do të ketë të drejtën të kryejë, në përputhje me aktet e zbatueshme të një ose më shumë institucioneve ose organeve të Bashkimit dhe siç parashikohet në marrëveshjet përkatëse dhe/ose kontratat, të rishikimeve dhe auditimeve teknike, shkencore, financiare ose lloje të tjera. në mjediset e çdo personi fizik me banim në Shqipëri ose të ndonjë personi juridik të vendosur në Shqipëri dhe që pëfiton fonde nga Bashkimi Evropian, si dhe çdo palë të tretë të përfshirë në zbatimin e fondeve të Bashkimit që banojnë ose janë vendosur në Shqipëri. Rishikime dhe auditimet të tilla mund të kryhen nga agjentët e institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian, në veçanti të



Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve, ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni Evropian.

2. Agjentët e institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian, në veçanti të Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve, dhe personat e tjerë të mandatuar nga Komisioni Evropian, do të kenë qasje në kantiere, punimet dhe dokumentet (si në versionet elektronike dhe të printuar) dhe për të gjithë informacionin e kërkuar për të kryer auditime të tilla, duke përfshirë të drejtën për të marrë një kopje fizike/elektronike dhe ekstrakte nga çdo dokument, ose përmbajtjen e çdo medium të të dhënave, mbajtur nga personi fizik ose juridik i audituar, ose nga pala e tretë e audituar.

3. Shqipëria nuk do të parandalojë apo paraqesë ndonjë pengesë të veçantë për të drejtën e hyrjes në Shqipëri dhe për qasje në mjediset e punës së agjentëve dhe personave të tjerë të përmendur në paragrafin 2, për arsye të ushtrimit të detyrave të tyre të përmendura në këtë nen.

4. Rishqyrtimet dhe auditimet mund të kryhen, gjithashtu pas pezullimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 6 pika 5 ose të ndërprerjes së saj, sipas kushteve të përcaktuara në aktet e zbatueshme të një ose më shumë institucione ose organeve të Bashkimit Evropian dhe siç parashikohet në marrëveshjet dhe/ose kontratat përkatëse në lidhje me çdo angazhim ligjor që zbaton buxhetin e Bashkimit Evropian dhe të miratuara nga Bashkimi Evropian përpara datës së hyrjes në fuqi të pezullimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje sipas nenit 6 pika 5, ose ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Mbrojtja ndaj parregullsive, mashtrimeve dhe veprave të tjera penale që prekin interesat financiare të Bashkimit

1. Komisioni Evropian dhe Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (ZEKM) do të autorizohen të kryejnë hetime administrative, duke përfshirë kontrolle dhe inspektime në vend, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto hetime do të kryhen në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara nga aktet në fuqi të një ose më shumë institucioneve të Bashkimit.

2. Autoritetet kompetente shqiptare do të informojnë Komisionin Evropian ose ZEKM-in

brenda një kohe të arsyeshme për çdo fakt ose dyshim për të cilin kanë marrë dijeni në lidhje me një parregullsi, mashtrim ose veprimtari tjetër të paligjshme që prek interesat financiare të Bashkimit.

3. Kontrollat dhe inspektimet në vend mund të kryhen në ambientet e çdo personi fizik rezident në Shqipëri ose person juridik të vendosur në Shqipëri dhe që merr fonde të Bashkimit, si dhe të çdo pale të tretë të përfshirë në zbatimin e fondeve të Bashkimit rezidente ose e vendosur në Shqipëri.

4. Kontrollat dhe inspektimet në vend do të përgatiten dhe kryhen nga Komisioni Evropian ose ZEKM-ja në bashkëpunim të ngushtë me autoritetin kompetent shqiptar të caktuar nga qeveria shqiptare. Autoriteti i caktuar do të njoftohet përpara një kohe të arsyeshme për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, në mënyrë që të mund të ofrojë ndihmë. Për këtë qëllim, zyrtarët e autoriteteve kompetente shqiptare mund të marrin pjesë në kontrollet dhe inspektimet në vend.

5. Me kërkesë të autoriteteve shqiptare, kontrollet dhe inspektimet në vend mund të kryhen së bashku me Komisionin Evropian ose ZEKM-në.

6. Agjentët e Komisionit dhe anëtarë të personelit të ZEKM-së do të kenë qasje në të gjithë informacionin dhe dokumentacionin, duke përfshirë të dhënat kompjuterike, për operacionet në fjalë, të cilat nevojiten për kryerjen në mënyrën e duhur të kontrolleve dhe inspektimeve në vend. Në veçanti, ata mund të kopjojnë dokumente të caktuara.

7. Në rastet kur personi, subjekti ose një palë tjetër e tretë e kundërshtojnë kontrollin ose inspektimin në vend, autoritetet shqiptare, duke vepruar në përputhje me rregullat dhe rregulloret kombëtare, do të ndihmojnë Komisionin Evropian ose ZEKM-në, për t'u lejuar atyre të kryejnë detyrën për realizimin e një kontrolli ose inspektimi në vend. Ndihma përfshin marrjen e masave të duhura paraprake sipas ligjit vendas, veçanërisht për të mbrojtur provat.

8. Komisioni Evropian ose ZEKM-ja do të informojnë autoritetet shqiptare për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve. Në veçanti, Komisioni Evropian ose ZEKM-ja do t'i raportojnë sa më shpejt të jetë e mundur autoritetit kompetent shqiptar çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi që është vënë re gjatë kontrollit ose inspektimit në vend.



9. Pa cënuar zbatimin e legjislacionit penal shqiptar, Komisioni Evropian mund të vendosë masa administrative dhe gjobë ndaj personave juridikë ose fizikë të Shqipërisë që marrin pjesë në zbatimin e një programi ose aktiviteti në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

10. Për qëllimet e zbatimit të duhur të këtij neni, Komisioni Evropian ose ZEKM-në dhe autoritetet kompetente shqiptare do të shkëmbejnë rregullisht informacione dhe do të konsultohen me njëra-tjetrën, me kërkesë të njëres prej palëve në këtë Marrëveshje.

11. Në mënyrë që të lehtësohet bashkëpunimi efektiv dhe shkëmbimi i informacionit me ZEKM-në, Shqipëria do të caktojë një pikë kontakti.

12. Informacioni i shkëmbyer ndërmjet Komisionit Evropian ose ZEKM-së dhe autoriteteve kompetente shqiptare do të bëhet duke pasur parasysh kërkesat e konfidencialitetit. Të dhënat personale të përfshira në shkëmbimin e informacionit do të mbrohen në përputhje me rregullat në fuqi.

13. Autoritetet shqiptare do të bashkëpunojnë me Prokurorinë Publike Evropiane për ta lejuar atë të përmbushë detyrën e saj për të hetuar, ndjekur penalisht dhe për të dërguar para gjykatës autorët dhe bashkëpunëtorët e veprave penale që prekin interesat financiare të Bashkimit Evropian në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Rikuperimi dhe zbatimi

1. Vendimet e miratuara nga Komisioni Evropian që vendosin një detyrim financiar ndaj personave juridikë ose fizikë të ndryshëm nga Shtetet, në lidhje me çdo pretendim që buron nga Programi i Europës Dixhitale do të jenë të zbatueshëm në Shqipëri. Urdhri për ekzekutimin do të bashkëngjitet vendimit, pa ndonjë formalitet tjetër përveç verifikimit të vërtetësisë së vendimit nga autoriteti kombëtar i caktuar për këtë qëllim nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'ia bëjë të njohur autoritetin e caktuar kombëtar Komisionit dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Në përputhje me nenin 4 të kësaj Shtojce, Komisioni Evropian gëzon të drejtën të njoftojë drejtpërdrejt personat rezidentë në Shqipëri dhe personat juridikë të vendosur në Shqipëri, vendime të tilla të

zbatueshme. Zbatimi do të bëhet në përputhje me ligjin dhe rregullat e procedurës shqiptare.

2. Vendimet dhe urdhrat e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian të marra në zbatim të një klauzole arbitrazhi të parashikuar në një kontratë ose marrëveshje në lidhje me programet, aktivitetet, veprimet ose projektet e Bashkimit do të jenë të zbatueshme në Shqipëri në të njëjtën mënyrë si vendimet e Komisioni Evropian të përmendura në paragrafin 1.

3. Gjykata e Evropiane e Drejtësisë ka juridiksion për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të përmendur në paragrafin 1 dhe për të pezulluar zbatimin e tij. Megjithatë, Gjykatat e Shqipërisë do të kenë juridiksion mbi ankesat lidhur me zbatimin në mënyrë të parregullt.

Neni 4

Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit

Institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian të përfshira në zbatimin e Programit të Europës Dixhitale, ose në kontrollet mbi atë program, kanë të drejtë të komunikojnë drejtpërdrejt, duke përfshirë përmes sistemeve të shkëmbimit elektronik, me çdo person fizik rezident në Shqipëri ose juridik të vendosur në Shqipëri dhe që merr fonde nga Bashkimi, si dhe me çdo palë të tretë të përfshirë në zbatimin e fondeve të Bashkimit. Këta persona, subjekte dhe palë të treta mund t'i paraqesin drejtpërdrejt institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian të gjithë informacionin dhe dokumentacionin përkatës që u kërkohet të paraqesin bazuar në legjislacionin e Bashkimit Evropian, i cili është i zbatueshëm për programet e Bashkimit dhe të kontratave ose marrëveshjeve të lidhura për zbatimin e këtij programi.

**DEKRET****Nr. 331, datë 20.11.2023****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 87/2023, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë, nga njëra anë, dhe Bashkimit Evropian, nga ana tjetër, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin e Bashkimit ‘Evropa Digjitale’ (2021–2027)”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM**Nr. 652, datë 22.11.2023****PËR CAKTIMIN E DITËS SË HËNË,
DATË 27.11.2023, DITË PUSHIMI**

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e ditës së hënë, datë 27.11.2023, ditë pushimi për punonjësit e administratës shtetërore.

2. Dita e punës, e datës 27.11.2023, do të zëvendësohet në një nga ditët e pushimit brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.

3. Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

URDHËR**Nr. 350, datë 16.11.2023****PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM TË
KOMPETENCAVE**

Në zbatim të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; të VKM-së nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”; të nenit 26, të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrit Qendror, z. Agron Cani.

2. Z. Agron Cani i delegohen kompetencat si më poshtë:

- ndjek dhe zbaton “Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar” (i ndryshuar);

- ndjek dhe monitoron prezencën në punë të personelit të AKSIK-së;

- ndjek detyrat e vendosura në planin mujor;

- merr dhe trajton korrespondencën shkresore.

3. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën nga data 20.11.2023 deri më 25.11.2023.

4. Z. Agron Cani nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrit Qendror.

6. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

7. Ky urdhër hartohet në 3 (tre) kopje të njëjta, një për Protokoll/Arkivin, një për Qendrën e



Botimeve Zyrtare dhe një për drejtorin e Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrimit Qendror.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dorian Tola

NJOFTIM
Nr. 17240, datë 17.11.2023

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, mbi bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së bimëve, nënshkruar në Podgoricë, më 27.2.2023, hyn në fuqi më 14 dhjetor 2023.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I
ÇËSHTJEVE POLITIKE DHE STRATEGJIKE
Sokol Dedja

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT
E NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

**Çështja Prodhim Veshje nr. 2 sh.a. kundër
Shqipërisë**
(Kërkesa nr. 34649/14)

VENDIM

STRASBURG
17 tetor 2023

Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

**Në çështjen Prodhim Veshje nr. 2 sh.a.
kundër SHQIPËRISË,**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet, i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *President,*
Darian Pavli,
Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit,*

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 34649/14) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa"), më 29 prill 2014 nga Prodhim Veshje nr. 2 sh.a., një shoqëri tregtare e themeluar në Shqipëri ("shoqëria kërkuuese") e përfaqësuar nga z. B. Rusi, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë ("Qeveria") të përfaqësuar nga agjentja në atë kohë znj. A. Hicka dhe më pas nga z. O. Moçka, avokat i përgjithshëm i shtetit për ankimet sipas nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me aksesin në Gjykatë, mungesën e paanshmërisë dhe mungesën e arsytimit, dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura, më 26 shtator 2023,

jep vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në atë datë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me shkeljen e dyshuar të së drejtës së shoqërisë kërkuuese për akses në Gjykatën Kushtetuese, mungesën e paanshmërisë së Gjykatës së Apelit dhe mungesën e arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

2. Në vitin 2006, një palë private filloi ndërtimin në një parcelë toke të pretenduar nga shoqëria kërkuuese. Në vitin 2007, shoqëria kërkuuese depozitoi një padë civile për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të saj të pronës dhe një masë sigurim padie kundër vijimit të ndërtimit në tokën e saj, bazuar në nenin 303 të Kodit Civil. Më 4 dhjetor 2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Gjykata e Rrethit) mori vendimin për *masën e sigurimit të padisë*, duke e ndaluar ndërtimin. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit, më 20 qershor 2008, dhe nga Gjykata e Lartë, më 26 shkurt 2009. Pas daljes së urdhrit të ekzekutimit, shoqëria kërkuuese filloi veprimet përmbarrimore. Më 14 maj 2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor rrëzoi padinë civile të palës kundërshtare kundër shoqërisë kërkuuese dhe kërkoj ndërprerjen e veprimeve përmbarrimore.

3. Më 29 shtator 2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor rrëzoi pretendimin e shoqërisë kërkuuese dhe hoqi masën e sigurimit të padisë, duke u



shprehur që nuk ishte pronare e tokës në fjalë dhe prandaj nuk kishte *locus standi*. Gjithashtu Gjykata e Rrethit Gjyqësor u shpreh që padia civile e shoqërisë kërkuuese ishte jashtë afatit sepse ishte depozituar një vit pas afatit të parashikuar në nenin 303 të Kodit Civil.

4. Më 11 nëntor 2009, Gjykata e Apelit e përbërë nga tre gjyqtarë pranoi padinë e kundërshtarit në lidhje me veprimet përmbarimore dhe i ndërpreu ato. Ajo u bazua, *inter alia*, në vendimin e 29 shtatorit 2008, që kishte refuzuar padinë e shoqërisë kërkuuese për themelin dhe kishte hequr masën e sigurimit të padisë.

5. Më 5 shkurt 2010, Gjykata e Apelit me të njëjtin trup gjyqësor që mori vendimin më 11 nëntor 2009, la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në lidhje me padinë civile të shoqërisë kërkuuese. Shoqëria kërkuuese nuk bëri kërkesë zyrtare që të tre gjyqtarët të tërhiqeshin nga çështja.

6. Më 4 mars 2010, shoqëria kërkuuese depozitoi një rekurs për çështjet e ligjit në Gjykatën e Lartë, duke u ankuar që tre gjyqtarët e Gjykatës së Apelit nuk ishin të paanshëm për shkak të përfshirjes së tyre në vendimin e 11 nëntorit 2009; që një ekspert teknik duhej të ishte caktuar nga gjykata; që ishte vlerësuar gabim që parcela e tokës në fjalë nuk ishte pronë e shoqërisë kërkuuese; që Agjencia Kombëtare e Privatizimit duhej të ishte ftuar të merrte pjesë në proces; dhe që pala kundërshtarë kishte paraqitur një dokument të falsifikuar. Më 25 mars 2011 ankimi u rrëzua *de plano*.

7. Më 31 tetor 2013, Gjykata Kushtetuese me trup gjyqësor me tetë gjyqtarë refuzoi ankimin e shoqërisë kërkuuese sepse votat u ndanë në mënyrë të barabartë. Arsjetimi u kufizua me faktin që gjykata nuk mund të arrinte shumicën për ndonjë nga problemet e ngritura në çështje. Shoqëria kërkuuese u informua për mundësinë, sipas nenit 74 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, e depozitimit të një ankimi të ri në një moment të mëvonshëm.

8. Në vitin 2016, ligji nr. 99/2016 i ndryshuar, neni 73 § 4 i ligjit për Gjykatën Kushtetuese nr. 8577/2000. Sipas këtyre ndryshimeve, nuk është më e mundur që të rrëzohet një ankim individual për shkak të votave të barabarta të Gjykatës Kushtetuese. Në çështjet ku gjykata nuk mund të arrijë shumicën prej pesë anëtarësh për ndonjë aspekt të ankimit kushtetues, që përfshin situatën e votave të barabarta, ankimi rrëzohet përfundimisht.

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. SHKELJA E DYSHUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS NË LIDHJE ME TË DREJTËN E AKSESIT NË GJYKATËN KUSHTETUESE

9. Qeveria argumentoi që shoqëria kërkuuese nuk kishte shteruar si duhej mjetet e brendshme ligjore sepse nuk kishte depozituar një ankim të ri kushtetues gjë të cilën kishte të drejtë ta bënte sipas nenit 131 § 1 (f) të Kushtetutës. Qeveria më tej argumentoi që shoqëria kërkuuese gjithashtu nuk kishte depozituar padi civile për dëmshpërblim kundër Shtetit.

10. Në lidhje me mundësinë e depozitimit të një ankimi të ri kushtetues, pas formimit të trupës së plotë të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata nuk mund të pranojë faktin që, thjesht se rrethanat mund të ndryshonin dhe ankuesi mund të kishte një vendim përfundimtar për kërkesën e tij në një kohë të papërcaktuar në të ardhmen, përmbush kërkesën për siguri juridike. (shihni *Marini kundër Shqipërisë*, nr. 3738/02 § 121, 18 dhjetor 2007). Prandaj shoqërisë kërkuuese, në rrethanat e çështjes në fjalë, nuk ju kërkuar të depozitonte një ankim të ri kushtetues.

11. Në lidhje me padinë civile për dëmshpërblim kundër Shtetit, Gjykata konsideron që një padi e tillë nuk mund të korrigjojë mungesën e aksesit të shoqërisë kërkuuese në Gjykatën Kushtetuese. Prandaj, Gjykata e rrëzon kundërshtimin e Qeverisë në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme ligjore në lidhje me këtë ankim. Gjykata vëren se nuk është e papranueshme për ndonjë shkak tjetër dhe që prandaj duhet të shpallet e pranueshme.

12. Mbetet të konstatohet nëse vendimi i rrëzimit të ankimit kushtetues të shoqërisë kërkuuese për shkak të votave të barabarta përbënte shkelje të së drejtës së saj për akses në Gjykatën Kushtetuese. Parimet e përgjithshme në lidhje me aksesin në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë sa i përket rrëzimit të ankimeve kushtetuese për mungesën e shumicës, përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 99/2016 (shihni paragrafin 8 prezantuar më sipër), janë përmbledhur në çështjen e lartpërmendur *Marini* (shihni §§ 118–123).

13. Qeveria u shpreh që situata e kësaj çështjeje ishte e ndryshme nga çështja e lartpërmendur *Marini*. Së pari, për shkak se situata e votave të barabarta nuk ishte problem strukturor i organizimit të Gjykatës Kushtetuese, por ishte një situatë e përkohshme jo e shkaktuar nga vetë gjykata. Së dyti, shoqëria kërkuuese mund të kundërshtonte përpara Gjykatës



Kushtetuese dispozitën ligjore që kishte shkaktuar rrëzimin e ankimit kushtetues për shkak të votave të barabarta.

14. Gjykata nuk sheh argumente me peshë për të dalluar çështjen në fjalë nga çështja *Marini*. Ankimi kushtetues i shoqërisë kërkues u rrëzua sepse anëtarët e trupës së gjykimit ishin ndarë dhe nuk u arrit shumica me pesë anëtarë e kërkuar me ligj. Kështu shoqëria kërkuese nuk arriti të merrte një vendim përfundimtar të çështjes së saj dhe në këto rrethana u kufizua vetë thelbi i të drejtës së saj për akses në Gjykatën Kushtetuese (krahasoni *Marini*, përmendur më sipër, §122). Nuk kishte ndonjë mundësi të afërt për ndryshimin e situatës, sepse një nga gjyqtarët kishte kërkuar përjashtimin për shkak të pjesëmarrjes së tij më përpara në trupën gjykuese të Gjykatës së Lartë për gjykimin e çështjes në fjalë.

15. Në këto rrethana, Gjykata konsideron që vendimi i kontestuar i Gjykatës Kushtetuese që rrëzon ankimin kushtetues të shoqërisë kërkuese për shkak të votave të barabarta, përbën mohim të pajustificuar të të drejtës së shoqërisë kërkuese për akses në Gjykatën Kushtetuese. Prandaj në këto rrethana konstatohet shkelje e nenit 6 § 1 të Konventës.

II. SHKELJE TË TJERA TË DYSHUARA SIPAS PRAKTIKËS GJYQËSORE TË MIRË-KONSOLIDUAR

16. Shoqëria kërkuese depozitoi dy ankime shtesë sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Së pari, u ankua që trupi gjykues i Gjykatës së Apelit që kishte rrëzuar ankimin nuk kishte qenë i paanshme, sepse ishte i njëjti trup gjykues që kishte pranuar padinë civile të palës kundërshtare vetëm dy muaj më parë (shihni paragrafin 5 më sipër).

17. Në lidhje me këtë ankim, Gjykata bie dakord me Qeverinë që shoqëria kërkuese nuk i ka shteruar mjetet e brendshme sepse nuk ka depozituar një kërkesë për tërheqjen e trupës së Gjykatës së Apelit, një mundësi kjo e parashikuar shprehimisht në nenet 72 dhe 74 të Kodit të Procedurës Civile. Këto dispozita parashikojnë që gjyqtarët kanë detyrimin të tërhiqen nga një çështje sa herë që konsiderojnë se ka konflikt interesi, rast në të cilin kryetarit të një gjykate të caktuar i takon të pranojë kërkesë për heqje dorë dhe të sigurojë zëvendësimin me një gjyqtar tjetër. Nëse një gjyqtar nuk tërhiqet me dëshirë, secila palë e procesit ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e tij. Kërkesa duhet të paraqitet brenda tre ditëve nga marrja dijeni për shkaqet e

pretenduara për heqjen dorë të gjyqtarit. Shoqëria kërkuese nuk ka përdorur procedurën standarde të paraqitjes së kërkesë për dorëheqjen e gjyqtarit të cilin konsideron se nuk është i paanshëm. Në ankimin e saj kushtetues, shoqëria kërkuese pranon shprehimisht që nuk ka depozituar një kërkesë të tillë.

18. Në këto rrethana, ky ankim duhet të refuzohet sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mos shterimin e mjeteve të brendshme ligjore.

19. Në lidhje me ankimin që Gjykata e Lartë kishte refuzuar rekursin e shoqërisë kërkuese për çështjet e ligjit pa dhënë arsye, Gjykata vëren që kërkuesi paraqiti rekursin në Gjykatën e Lartë me arsyen se vendimet e gjykatave më të ulëta ishin të pambështetura në ligj. Gjykata konsideron se arsyet e kufizuara të dhëna nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit të saj *de plano*, megjithatë treguan në mënyrë të nënkuptuar që kërkuesi nuk kishte ngritur ndonjë nga çështjet e ligjit të parashikuara në dispozitat e brendshme përkatëse, gjë që është kërkesë për pranueshmërinë e ankimit. Gjykata vëren se kur Gjykata e Lartë refuzon të pranojë një çështje për faktin se arsyet ligjore për një çështje të tillë nuk janë të mbështetura, arsyetimi shumë i kufizuar mund të plotësojë kërkesat e nenit 6 të Konventës (shihni *Marini*, lartpërmendur § 106).

20. Në këto rrethana, ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

21. Shoqëria kërkuese pretendoi 243,135 EUR dëmshpërblim monetar dhe jo monetar dhe 78,000 EUR për kosto dhe shpenzime të kryera për gjykatat e brendshme dhe për Gjykatën.

22. Qeveria gjykon që shumat e pretenduara janë të pabazuara dhe të tepruara.

23. Gjykata përsërit që një vendim ku konstatohet shkelje vendos ndaj Shtetit të paditur detyrimin ligjor për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të rregulluar pasojat e tij. Nisur nga natyra e ankimit të shoqërisë kërkuese dhe e shkeljes së konstatuar, Gjykata konsideron se forma më e përshtatshme e korrigjimit në këtë çështje do të ishte rihapja e procesit përpara Gjykatës Kushtetuese, nëse e kërkon shoqëria kërkuese, nisur nga fakti që është në gjendje të sigurojë *restitutio in integrum* siç e kërkon neni 41 i Konventës (krahasoni *Shkalla kundër Shqipërisë*, nr. 26866/05, §§ 77–79, 10 maj 2011, dhe *X kundër Holandës*, nr. 72631/17, § 61, 27 korrik



2021). Në këtë drejtim, Gjykata vëren që neni 71/c i ligjit për Funkcionimin dhe Organizimin e Gjykatës Kushtetuese parashikon që proceset në Gjykatën Kushtetuese mund të rihapen nëse një gjykatë ndërkombëtare, juridiksioni i të cilës shtrihet ndaj Republikës së Shqipërisë konstaton se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të një personi “për shkak të një vendimi [të mëparshëm] të Gjykatës Kushtetuese”. Thënë kjo, konstatimi i një shkeljeje përbën shpërblim mjaftueshëm të drejtë në këtë çështje.

24. Në lidhje me kostot dhe shpenzimet për gjykatat e brendshme dhe Gjykatën, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, kërkuesi ka të drejtë për rimbursim vetëm në masën që tregohet se këto kosto dhe shpenzime janë bërë në fakt dhe kanë qenë të nevojshme dhe janë të arsyeshme në lidhje me dëmshpërblimin. Në këtë çështje, Gjykata refuzon pretendimin për kosto dhe shpenzime në procese gjyqësore të brendshme dhe e konsideron të arsyeshme dëmshpërblimin në shumën 2000 EUR (dy mijë euro) për proceset në Gjykatës, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet shoqërisë kërkuese.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. *shpall* të pranueshëm ankimin në lidhje me të drejtën e aksesit në Gjykatën Kushtetuese të shoqërisë kërkuese, dhe *vendos* që ankimet e tjera janë të papranueshme;

2. *shprehet* që konstaton shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës;

3. *shprehet* që konstatimi i shkeljes përbën në vetvete shpërblim mjaftueshëm të drejtë për çdo dëm jo monetar të përjetuar nga shoqëria kërkuese;

4. *shprehet*

a) që Shteti i paditur duhet t'i paguajë shoqërisë kërkuese, brenda tre muajve, 2,000 EUR (dy mijë euro), plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet shoqërisë kërkuese, në lidhje me kostot dhe shpenzimet, që do të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur me kursin në fuqi në datën e shlyerjes;

b) që nga mbarimi i afatit të sipërpërmendur tre mujor deri në datën e shlyerjes, interes i thjeshtë të paguhet për shumat e mësipërme sipas normës të njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pike përqindje;

5. *rrëzën* pretendimin e shoqërisë kërkuese për shpërblim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim, më 17 tetor 2023, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
Zëvendëskancelare

Georgios A. Serghides
President

VENDIM

**Nr. 1 (Nj) 2023 i regjistrat themeltar
datë 14.11.2023**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Illir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare,

në datën 14.11.2023, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim të paraqitur në çështjen nr. 1 (Nj) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Një grup deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (jo më pak se një e pesta e deputetëve),

Anxhela Gjini, Alesia Cara, Diora Hoxha, Argisa Troka, Xhesika Xhebexhiu, Juri Taullau, Sindy Allamani, Isabela Tabaku, Dea Guri, Natali Bliu, Joel Plaku, Mikel Seferi, Reant Kullaj, Brunelio Fejzulla, Viki Zaçlli, Rei Haluli, Feruze Agalliu, Oresti Çaçë, Marjo Rabiçaj, Paulo Qesargjoni, Endi Muçi, Arbëri Shehu, Samuel Dërka, Thimi Shkarpa, Kristina Çelanji, Athina Prifti, Almira Tota, Zino Veleshnja, Erdi Podo, Anxhela Miraka, Gani Krrashi, Klevis Gugallja, Flavio Elezi, Ledion Mane, Eugen Lazaj, Igli Hoxhaj, Arlind Kasëmi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave,

OBJEKTI: Shfuqizimi i nenit 4, pikat 1, shkronja “c”, 2, shkronja “b” dhe 3, shkronja “b”, si dhe i nenit 5, fjalia e parë, të ligjit nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e Përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.



Pezullimi i ligjit nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e Përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë” deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 18, 26, 49, 57, 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 4 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 2, i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (Mbledhja e Gjyqtarëve), pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 60/2023,

VËREN:

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), në bazë të propozimit të Këshillit të Ministrave dhe në zbatim të procedurës së përshpejtuar parlamentare, në datën 21.7.2023, ka miratuar ligjin nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e Përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë” (ligji nr. 60/2023). Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 123, datë 16.8.2023 dhe ka hyrë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit, në datën 31.8.2023.

2. Neni 4, i ligjit nr. 60/2023, parashikon: “1. Trajtim të veçantë përfiton kandidati që pranohet në programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë kur plotëson kushtet si më poshtë: a) plotëson deklaratën për përmbushjen e kushteve, parashikuar në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1 të këtij neni, përpara zhvillimit të testimit të detyruar për pranimin në këtë program studimi; b) nënshkruan marrëveshje para regjistrimit të tij si fitues në këtë program, e cila lidhet ndërmjet tij, ministrisë përgjegjëse për arsimin, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionit të arsimit të lartë publik për të punuar në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve për jo më pak se 5 (pesë) vjet në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë; c) pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas

afatit 5-vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit të tërheqë diplomën universitare. 2. Trajtim të veçantë përfiton studenti i vitit të dytë deri në vitin e katërt akademik kur pranon përmbushjen e kushteve si më poshtë: a) nënshkruan marrëveshje para fillimit të vitit akademik përkatës dhe për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së studimeve, e cila lidhet ndërmjet tij, ministrisë përgjegjëse për arsimin, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionit të arsimit të lartë publik për të punuar në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve për jo më pak se 3 (tre) vjet në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë; b) pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit 3-vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit kandidati të tërheqë diplomën universitare. 3. Trajtim të veçantë përfiton studenti i vitit të pestë ose të gjashtë në këtë program kur pranon përmbushjen e kushteve si më poshtë: a) nënshkruan marrëveshje para fillimit të vitit akademik përkatës dhe për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së studimeve, e cila lidhet ndërmjet tij, ministrisë përgjegjëse për arsimin, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionit të arsimit të lartë publik për të punuar në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve për jo më pak se 2 (dy) vjet në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë; b) pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit 2-vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit kandidati të tërheqë diplomën universitare.”.

3. Po kështu, fjalia e parë e nenit 5 të këtij ligji parashikon: “Studenti që nuk pranon të nënshkruajë marrëveshje për të punuar në një institucion shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, publik ose privat, nga data e lindjes të së drejtës për punësim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionin e arsimit të lartë publik sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3, të nenit 4 të këtij ligji, paguan vlerën e plotë të kostos së studimeve [...]”.

4. Në datat 19.10.2023 dhe 20.10.2023, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me dy kërkesa të veçanta për shfuqizimin e nenit 4, pikat 1, shkronja “c”, 2, shkronja “b” dhe 3, shkronja “b”, si dhe të nenit 5, fjalia e parë, të ligjit nr. 60/2023, pasi vijnë në kundërshtim me nenet 4, 17, 18, 26, 49 dhe 57 të Kushtetutës. Kërkuesit kanë kërkuar edhe pezullimin e zbatimit të këtyre dispozitave, deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës.



Në lidhje me këto kërkesa, me vendimin e datës 8.11.2023, të Kolegjit të Gjykatës, është vendosur kalimi i tyre për shqyrtim në seancë plenare publike dhe me vendimin e datës 14.11.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur edhe bashkimin e tyre në një çështje të vetme.

5. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se neni 45, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000, si dhe nenet 11, pika 3, shkronja “P” dhe 27, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës parashikojnë se Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palëve, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve, sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancë plenare urdhëron pezullimin e tij. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës të hyjë në fuqi. Në kushtet kur pezullimi është një masë e jashtëzakonshme, vendosja e tij lidhet me vlerësimin e pasojave ose efekteve të zbatimit të aktit. Këto pasoja jo vetëm duhet të jenë reale, pra në realizim e sipër, por edhe të rënda, në atë masë që shkojnë tej masës normale të kufizimit, në veçanti në pikëpamje të urgjencës.

6. Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve, pasi mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, vlerëson se ekzistojnë shkaqet e parashikuara nga neni 45, i ligjit nr. 8577/2000, që përligjin pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 60/2023. Konkretisht, parashikimi në ligj i nënshkrimit të marrëveshjes para regjistrimit të studentëve në programin e studimeve ka shkaktuar ndërprerjen e procesit mësimor për shkak të protestave deri në bojkot të studentëve, të cilët pretendojnë cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe barazisë para ligjit, të së drejtës për arsim dhe punë të tyre. Kjo situatë mbështet pretendimin për mundësinë e ardhjes së pasojave të pariparueshme ndaj të drejtave të tyre, por edhe në kuptim të urgjencës që legjitimon caktimin e masës së përkohshme të pezullimit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson të pranojë kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 60/2023, deri sa vendimi përfundimtar të hyjë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 45, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 11, pika 3,

shkronja “P”, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e Përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë”.

2. Njoftimin e kërkuarve dhe të subjekteve të interesuara për marrjen e masës së pezullimit të ligjit.

3. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese dhe dërgimin e tij për botim në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 14.11.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

Anëtar kundër: Ilir Toska

VENDIM

Nr. 50, datë 18.10.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 18.10.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (M) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Muhamet Trepçi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Fatime Trepçi, Shyqyrie Trepçi, Qeothere Kurti (Trepçi);



Agjencia e Trajtimit të Pronave; Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 569, datë 25.2.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-2177, datë 5.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, pretendimet e subjekteve të interesuara, Agjencisë së Trajtimit të Pronave (*ATP*) dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuar është njëri prej trashëgimtarëve ligjorë të shtetases N.S. (T.), gjyshja e tij. Në datën 14.10.2008, ai i është drejtuar Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Shkodër, me kërkesë për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e pronës së paluajtshme të gjyshes së tij, si subjekt i shpronësuar, për një truall me sipërfaqe 1.540 m², të ndodhur në lagjen “Pazar”, zona kadastrale nr. 8591, Bashkia Shkodër.

2. Për shkak të suprimimit të zyrës rajonale me ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar (*ligji nr. 9235/2004*), në kushtet kur kërkesa e kërkuarit dhe trashëgimtarëve të tjerë nuk ishte shqyrtuar ende, ajo është marrë në shqyrtim nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*AKKP*), e cila, me vendimin nr. 1301, datë 18.11.2011, ka vendosur: 1. pranimin e kërkesës; 2. njohjen e së drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme truall me sipërfaqe 1.500 m² të subjektit

të shpronësuar N.S.S. (T.), trashëgimtarëve të saj ligjorë, sipas kufizimeve përkatëse; 3. njohjen e së drejtës së kompensimit për këtë pronë të paluajtshme subjektit të shpronësuar N.S.S. (T.), trashëgimtarëve të saj ligjorë. *AKKP*-ja ka konkluduar, ndër të tjera, se nga hetimi që u ka bërë akteve shkresore të administruara dhe rezultateve të kryera në terren, sipërfaqja e pronës ishte 1.500m² dhe jo 1.540m² dhe se ajo ishte kthyer në lulishte e po përdorej për qëllime publike. Sipas këtij institucioni, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZVRPP*) ka konfirmuar se pasuria e pretenduar me nr. 18/193, e ndodhur në zonën kadastrale nr. 8591, ka si pronar shtetin, ndërsa Bashkia Shkodër ka konfirmuar se me vendimin nr. 366, datë 27.3.2008, të Këshillit të Ministrave (*VKM nr. 366/2008*), kjo pronë është regjistruar në inventarin e pasurive të saj dhe se ajo përfshihet në zonën e gjelbër të qytetit. Në përfundim, *AKKP*-ja ka konkluduar se prona nuk mund t’u kthehej subjekteve pretenduese, për sa kohë shfaqte rëndësi të veçantë publike, në referim të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 9235/2004, por ata kishin të drejtën e kompensimit në një nga format e parashikuara nga neni 11 i këtij ligji dhe, nëse ajo ishte kthyer në hapësirë publike, në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fuqi, kërkuar duhej t’i drejtoheshin rrugës gjyqësore për të verifikuar këtë fakt. Po sipas *AKKP*-së, nëse destinacioni i pronës do të ndryshonte e nuk do të përdorej më për shërbime ose veprimtari me karakter publik, trashëgimtarët e subjektit N.S.(T). kishin të drejtë të ishin të parët në radhë preferenciale për t’u vënë në disponim të kësaj sipërfaqeje.

3. Kërkuar dhe bashkëtrashëgimtarët e tjerë i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi për anulimin pjesërisht të vendimit nr. 1301, datë 18.11.2011, të *AKKP*-së dhe kthimin fizik të sipërfaqes prej 1.500 m², për të cilën gjykata, me vendimin nr. 1483, datë 18.2.2013, ka vendosur: “*Pranimin e kërkesëpadisë. Ndryshimin e pikës 3, të vendimit nr. 1354, datë 5.12.2011, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Kthimin paditësve Muhamet Trepçi, Fatime Trepçi, Shyqyrije Trepçi (Kopliku) dhe Qeothere Kurti (Trepçi), të sipërfaqes së njohur prej 1.500m², sipas planvendodhjes bashkëngjitur këtij vendimi.*”. Gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se *AKKP*-ja nuk ka kryer hetim të plotë në funksion të marrjes së të dhënave, me qëllim konfigurimin e parcelës “lulishte-pazar”. Ajo ka konfirmuar vetëm gjendjen juridike të



sipërfaqes prej 1500 m², por jo të të gjitha ndërtimeve të përfshira brenda parcelës. Gjatë kohës që AKKP-ja shqyrtonte kërkesën, parcela, përfshirë sipërfaqen 1500 m², nuk ka qenë as në pronësi dhe as në përdorim të Bashkisë Shkodër, por ishte në fazën e pritjes për t'i kaluar asaj në përdorim ose pronësi me fushë përdorimi lulishte dhe rrugë, për rrjedhojë sipërfaqja prej 1500 m² *de jure* nuk i shërbente, por potencialisht mund t'i shërbente një interesi publik. Sipas konfirmimeve të Bashkisë Shkodër, parcela “lulishte-pazar” i përket zonës së gjelbër të qytetit të Shkodrës, sipas planit rregullues, pra i shërben një interesi publik. Kjo rrethanë është bërë shkak për kufizimin e së drejtës së trashëgimtarëve, duke iu njohur në vend të së drejtës së kthimit fizik të pronës, të drejtën e kompensimit. Nga ana tjetër, kjo rrethanë nuk ka penguar institucionet shtetërore të pajisin me leje ndërtimi e të transkriptojnë titujt e pronësisë mbi 7 objektet e ngritura brenda konturit të kësaj parcele ose të jenë penguar nga inspektorët e ndërtimit 23 qytetarët që kanë ngritur brenda saj objekte në mënyrë informale, aktualisht në proces legalizimi. Po sipas gjykatës, panorama kaotike e parcelës “lulishte-pazar” nuk ka asnjë pikë të përbashkët me konceptin e pasurisë që i shërben një interesi publik dhe në rastin në shqyrtim janë penalizuar vetëm paditësit, trashëgimtarë të subjektit të shpronësuar.

4. Mbi bazën e ankimit të bërë nga AKKP-ja, me vendimin nr. 569, datë 25.2.2014, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë, duke vlerësuar se AKKP-ja kishte kryer hetim të plotë. Sipas saj, pas konfirmimit se prona objekt gjykimi është pjesë e parcelës “lulishte-pazar”, AKKP-ja nuk ka vijuar hetimin në funksion të marrjes së të dhënave me qëllim konfigurimin e kësaj parcele, rrjedhimisht në vendimin e saj nuk ka të dhëna për sipërfaqen totale të parcelës. Po sipas gjykatës, përmes ZVRPP-së, Shkodër, AKKP-ja ka konfirmuar vetëm gjendjen juridike të sipërfaqes prej 1500 m², por jo të të gjitha ndërtimeve të përfshira brenda parcelës “lulishte-pazar”. Gjatë kohës që AKKP-ja shqyrtonte kërkesën, kjo parcelë, përfshirë edhe sipërfaqen prej 1500 m², nuk ka qenë as në pronësi, as në përdorim të Bashkisë Shkodër, por ishte në fazën e pritjes për t'i kaluar asaj në përdorim ose pronësi me fushë përdorimi lulishte dhe rrugë. Sipërfaqja prej 1500 m² *de jure* nuk i shërbente, por potencialisht mund t'i shërbente një

interesi publik, duke qenë në fazën e pritjes së miratimit të listës së pronave të kërkuara për t'u regjistruar në përdorim ose pronësi të Bashkisë Shkodër. Konkluzioni i AKKP-së se sipërfaqja prej 1500 m² përdorej *de facto* si lulishte është rezultat i verifikimit në terren të kryer prej saj, konkretisht i disa fidanëve të mbjellë dhe disa rrugicave të shtruar me pllaka, duke krijuar panoramën që i përshtatet një lulishteje, rrethanë penguese kjo për kthimin e pronës ish-pronarit.

5. Në datën 19.3.2014, kërkuesi ka ushtruar rekurs ndaj vendimit të lartpërmendur të gjykatës së apelit dhe në datën 2.9.2016, ka paraqitur shtesë rekursi. Me vendimin nr. 00-2022-2177, datë 5.10.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar, ndër të tjera, se kërkuesi ka ngritur të njëjtat pretendime të ngritura në gjykatën e shkallës së parë, për të cilat ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykata e apelit. Kjo e fundit ka respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material dhe atij procedural dhe vendimi i saj nuk bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndërsa pretendimet e kërkuetit që ngrenë çështje të vlerësimit të provave dalin jashtë juridiksionit rishikues të Gjykatës së Lartë. Për sa i përket pretendimit me natyrë kushtetuese të ngritur në rekurs për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, për shkak se në pronën e pretenduar, të vlerësuar në referim të provave të marra gjatë gjykimit se i shërben interesit publik, janë lejuar të kryhen ndërtime nga individë të ndryshëm, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se nuk mund të merret në konsideratë prej saj, për sa kohë që bazohet në premisën e respektimit të barazisë në shkeljen e interesit publik, që nuk mund të ishte kurrësi e pranueshme në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës. Po sipas kësaj gjykate, në rastin konkret, kufizimi i së drejtës së pronësisë së paditësit është parashikuar nga ligji, për shkak të mbrojtjes së interesit publik dhe nuk mund të konsiderohet se cenon thelbin e kësaj të drejte, në kuptim të nenit 1, të Protokollit nr. 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), si dhe neneve 17 dhe 41 të Kushtetutës.

6. Në datën 31.1.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve të gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se i kanë cenuar të drejta kushtetuese.



7. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 133/2015, datë 5.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (*ligji nr. 133/2015*), AKKP-ja është transformuar në ATP (*neni 32 i ligjit*). Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi, emrat e këtyre institucioneve janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës që janë kryer veprimet prej tyre.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i janë cenuar:

8.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka verifikuar dhe nuk është shprehur nëse në gjendjen ekzistuese të “lulishte-pazar”, me ndërtime të shumta në të, gjenin zbatim vendimet për lënien në funksion publik të pronës së tij.

8.2 *E drejta e pronës*, si rrjedhojë e moskthimit të saj, por njohjes së të drejtës së kompensimit. Sipas tij, prona nuk përdoret për shërbime ose veprimtari me karakter publik. Leja e ndërtimit që i është dhënë në vitin 1998 tregon se ajo nuk përbën më një interes publik dhe se plani i mëparshëm rregullues i qytetit të Shkodrës është bërë i pazbatueshëm. Në vitin 2005 është miratuar rishikimi i këtij plani, përmes të cilit një pjesë e sipërfaqes së “lulishte-pazar” është kthyer nga “zonë e gjelbër” në “zonë tregtare”. Ndryshimi i destinacionit të kësaj lulishteje është konfirmuar nga vetë autoritetet shtetërore, çka është pranuar edhe nga gjykata e rrethit edhe nga gjykata e apelit. Sipas këtyre gjykatave, sipërfaqja e “lulishte-pazar” nuk ka qenë as në pronësi, as në përdorim të Bashkisë Shkodër, por potencialisht mund t'i shërbente një interesi publik. Ndërkohë, ligji nr. 9235/2004 përcaktonte se nuk kthehen pronat e paluajtshme që i shërbejnë një interesi publik dhe jo ato që mendohej se do i shërbenin në të ardhmen. Në parcelën “lulishte-pazar”, ku përfshihet edhe prona e tij, ka një sërë ndërtimesh, një pjesë e të cilave me leje ndërtimi të miratuara nga bashkia ose këshilli i qarkut dhe një pjesë tjetër në proces legalizimi. Prona nuk u kthehet prej 31 vjetësh me argumentin se është pronë publike, ndërkohë që deri tani nuk është përdorur për asnjë funksion publik.

8.3 *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, si rrjedhojë e mohimit të dhënies së

lejes së ndërtimit mbi pronën, në krahasim me personat e tjerë që kanë ndërtuar në sipërfaqen “lulishte-pazar”, për më tepër ata që nuk kanë qenë ndonjëherë pronarë në ato sipërfaqe.

9. *Subjekti i interesuar, ATP-ja*, i përfaqësuar nga *Avokatura e Shtetit*, ka prapësuar se:

9.1 Pretendimet e kërkuesit, në thelb, kanë të bëjnë me përcaktimin e fakteve përmes provave të shqyrtuara në gjykim, çka nuk i përket juridiksionit kushtetues.

9.2 Pretendimet për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, duke sjellë si pasojë edhe cenimin e së drejtës së pronës, janë tërësisht të pambështetura dhe nuk reflektojnë shkelje të të drejtave kushtetuese.

9.3 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* është haptazi i pabazuar. Kufizimi i kësaj të drejte është parashikuar nga ligji, për shkak të mbrojtjes së interesit publik dhe nuk cenon thelbin e saj. Prona objekt shqyrtimi figuron e regjistruar në inventarin e pronave të Bashkisë Shkodër të miratuar me VKM-në nr. 366/2008, çka është konfirmuar edhe nga kjo bashki. Nga verifikimi i AKPP-së në terren ka rezultuar se prona është kthyer në lulishte dhe po përdoret aktualisht për qëllime publike, për rrjedhojë nuk mund të jetë objekt i kthimit fizik për sa kohë shfaq rëndësi të veçantë publike, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 9235/2004.

9.4 Pretendimi i kërkuesit për shkeljen e *parimit të barazisë përpara ligjit* është haptazi i pabazuar. Nëse ndërtimet në hapësirën publike janë kryer në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fuqi, nuk i përket çështjes objekt shqyrtimi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo



rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar. Po kështu, pretendimet e parashtruar në ankimin kushtetues individual i ka parashtruar në gjykatat e zakonshme dhe vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë ka përmbyllur procesin gjyqësor për çështjen e pronës, për rrjedhojë, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata çmon se ai e plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive* në dispozicion përpara se t’i drejtohet Gjykatës. Në drejtim të legjitimitetit *ratione temporis*, Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 5.10.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 31.1.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

12. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit, si dhe të drejtën e pronës e parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit. Subjektet e interesuara, ATP-ja dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se Gjykata nuk ka juridiksion, pasi pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me përcaktimin e fakteve përmes provave të shqyrtuara në gjykim.

13. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë prej saj vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim

të natyrës kushtetuese të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se detyrë e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventalisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 30.5.2023; nr. 41, datë 22.12.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se në kundërshtim nga sa pretendohet nga subjektet e interesuara, pretendimet e parashtruar në ankimin kushtetues individual përfshihen brenda juridiksionit të saj dhe kërkuesi legjitimohet *ratione materiae* në lidhje me to. Gjykata vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor të zhvilluar nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë për sa i përket njohjes së të drejtës së tij për kthimin e pronës private. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh thelbin e këtyre pretendimeve, Gjykata çmon t’i analizojë ato në themel në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me të drejtën e pronës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me të drejtën e pronës

15. Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor dhe të drejtën e pronës, si rrjedhojë e moskthimit të saj, por njohjes së të drejtës së kompensimit. Sipas tij, prona nuk përdoret për shërbime ose veprimtari me karakter publik. Leja e ndërtimit që i është dhënë në vitin 1998 tregon se ajo nuk përbën më interes publik dhe se plani i mëparshëm rregullues i qytetit të Shkodrës është bërë i pazbatueshëm. Me planin rishikues të qytetit të vitit 2005, një pjesë e sipërfaqes së “lulishtepazar”, ku ndodhet edhe prona e tij, është kthyer nga “zonë e gjelbër” në “zonë tregtare” dhe ndryshimi i destinacionit të kësaj lulishteje është konfirmuar nga vetë autoritetet shtetërore. Sipërfaqja e “lulishtepazar” nuk ka qenë as në pronësi, as në përdorim të Bashkisë Shkodër, por potencialisht mund t’i shërbente një interesi publik. Ligji nr. 9235/2004, përcaktonte se nuk kthehen pronat e paluajtshme që i shërbejnë një interesi publik dhe jo ato që mendohej se do i shërbenin në të ardhmen. Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka verifikuar dhe nuk është shprehur nëse në gjendjen ekzistuese të “lulishte-



pazar”, me ndërtime të shumta në të, gjenin zbatim vendimet për lënien në funksion publik të pronës së tij. Mohimi i dhënies së lejes së ndërtimit mbi këtë pronë ka bërë që ai të diskriminohet në krahasim me personat e tjerë që kanë ndërtuar në sipërfaqen e “lulishte-pazar”, për më tepër ata që nuk kanë qenë ndonjëherë pronarë në ato sipërfaqe.

16. Subjektet e interesuara, ATP-ja dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se pretendimet e kërkuarit janë haptazi të pabazuara. Sipas tyre, pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, duke sjellë si pasojë edhe cenimin e së drejtës së pronës, janë tërësisht të pambështetura dhe nuk reflektojnë shkelje të të drejtave kushtetuese. Në rastin e tij, kufizimi i pronës është parashikuar nga ligji, për shkak të mbrojtjes së interesit publik dhe nuk cenon thelbin e saj. Prona e regjistruar në inventarin e pronave të Bashkisë Shkodër, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave, është kthyer në lulishte dhe po përdoret për qëllime publike, për rrjedhojë nuk mund të jetë objekt kthimi fizik, për sa kohë shfaq rëndësi të veçantë publike, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 9235/2004. Po kështu, pretendimi për shkeljen e parimit të barazisë përpara ligjit është haptazi i pabazuar, pasi nëse ndërtimet në hapësirën publike janë kryer në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fuqi, nuk i përket çështjes objekt shqyrtimi.

17. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 33, datë 30.5.2023; nr. 11, datë 10.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në lidhje me të drejtën e pronës private, Gjykata ka theksuar se kriteret që parashikon neni

41 i Kushtetutës, që janë garantimi i pronës private dhe shpërblimi i drejtë, si dhe koncepti i përcaktuar nga KEDNJ-ja për gëzimin e pronës në mënyrë të qetë, janë orientimet bazë mbi të cilat duhet të zgjidhen të gjitha çështjet që lidhen me shpronësimet. Në një shtet demokratik individit duhet t’i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i së drejtës së pronës. Garantimi i kësaj të drejte përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike dhe askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik. Sipas nenit 17 të Kushtetutës, kufizimi i së drejtës së pronës mund të bëhet vetëm me ligj, për një interes publik dhe në përputhje me gjendjen që e ka diktuar atë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 15, datë 22.6.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Ashtu siç është trajtuar në praktikën kushtetuese, koncepti kushtetues i interesit publik është mjaft i gjerë dhe vlerësohet nga Gjykata në këndvështrim të aktit konkret që paraqitet për kontroll përpara saj, pasi është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyen publike që çojnë në kufizimin e një të drejte themelore (*shih vendimin nr. 33, datë 30.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nën dritën e garancive të parashikuara nga nenet 41 e 42 të Kushtetutës, si dhe kriterëve të përcaktuar nga neni 17 i saj, Gjykata çmon të analizojë nëse këto kriterë janë vlerësuar e zbatuar drejt në rastin konkret nga gjykatat e apelit dhe Gjykata e Iartë, vendimet e të cilave kërkuari kundërshton, konkretisht nëse ato kanë analizuar dhe vlerësuar kuadrin ligjor që ka përcaktuar ndërhyrjen në të drejtën e tij të pronës, ekzistencën e interesit publik për përdorimin e pronës si hapësirë publike të tillë që justifikon ndërhyrjen në këtë të drejtë, si dhe nëse mes këtij interesi e së drejtës së kërkuarit për pronën private është vendosur balanca e drejtë dhe ndërhyrja ka qenë proporcionale.

21. Kështu, Gjykata vëren se në cilësinë e njërit prej trashëgimtarëve kërkuari i është drejtuar zyrës vendore të AKKP-së, Shkodër me kërkesë për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e pronës së paluajtshme të gjyshes së tij. AKKP-ja ka vendosur njohjen e së drejtës së trashëgimtarëve për t’u kompensuar, por jo të së drejtës për kthimin e pronës, pasi, sipas saj, me VKM-në nr. 366/2008 prona ishte regjistruar në inventarin e pasurive të Bashkisë Shkodër, sipërfaqja e saj i shërbente



interesit publik dhe ishte kthyer në hapësirë publike. Në këto kushte, bazuar në nenin 7, pika 1, të ligjit nr. 9235/2004, prona nuk mund të kthehej fizikisht (*shih vendimin nr. 1301, datë 18.11.2011, të AKKP-së, faqja 9*).

22. Në vijim, së bashku me trashëgimtarët e tjerë, kërkuesi i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar kthimin fizik të pronës. Gjatë gjykimit gjyqësor të çështjes, organet shtetërore, AKKP-ja dhe Bashkia Shkodër kanë justifikuar ndërhyrjen me funksionin e pronës në fushën e infrastrukturës vendore, si lulishte. Në analizë të dispozitave të ligjit nr. 9235/2004, VKM-së nr. 255, datë 13.4.2010, “Për procedurat e mbledhjes, përpunimit, dhe administrimit të akteve të subjekteve të shpronësuar, gjatë procesit të njohjes dhe kthimit apo kompensimit të pronës”, VKM-së nr. 366/2008 dhe vendimit nr. 144, datë 30.12.2010, të Këshillit Bashkiak Shkodër “Për pronat shtetërore që kërkohet të kalohen në pronësi të Bashkisë Shkodër, me fushë përdorimi lulishte dhe rrugë”, gjykata e rrethit i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e AKKP-së dhe të Bashkisë Shkodër, duke pasur parasysh situatën faktike të “lulishte-pazar” në momentin e shqyrtimit të çështjes prej saj, e cila nuk i shërbente interesit publik (*shih vendimin nr. 1483, datë 18.2.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, faqet 3–6*).

23. Në analizë të kuadrit ligjor dhe pretendimeve të parashtruara nga palët në gjykim, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit, duke vlerësuar se ndonëse *de jure* prona nuk i shërbente një interesi publik, ajo mund t'i shërbente potencialisht në të ardhmen (*shih vendimin nr. 569, datë 25.2.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë, faqet 5–6*), ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit kishte zbatuar drejt dispozitat e ligjit procedural dhe atij material, pasi kufizimi i së drejtës së pronës ishte parashikuar nga ligji, për qëllime të mbrojtjes së interesit publik dhe kërkuesi nuk mund të pretendonte barazi përpara ligjit në raport me personat e tjerë që, në shkellje të këtij interesi, kishin ndërtuar në mënyrë të paligjshme në parcelën “lulishte pazar” (*shih vendimin nr. 00-2022-2177, datë 5.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, faqet 9–10*).

24. Gjykata vëren se në kohën e gjykimit të çështjes së kërkuarit, kushtet dhe kriteret për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve parashikoheshin nga ligji nr. 9235/2004, sipas

pikave 1 dhe 2 të nenit 7 të të cilit nuk ktheheshin pronat e paluajtshme që i shërbenin një interesi publik, çka është përcaktuar drejt nga gjykatat e zakonshme gjatë vlerësimit të kriterit të ndërhyrjes me ligj në të drejtën e pronës së kërkuarit. Po kështu, nga materialet e çështjes rezulton se me VKM-në nr. 366/2008 parcela “lulishte-pazar” në qytetin e Shkodrës është përfshirë në listën paraprake të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, ndërkohë që lista përfundimtare e pronave kaluar kësaj bashkie është miratuar me vendimin nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave (VKM nr. 421/2010).

25. Për sa i takon arsyetimit të gjykatave në lidhje me interesin publik, si shkak për moskthimin e pronës, Gjykata konstaton se gjykata e apelit ka mbështetur kufizimin e të drejtës së pronës së kërkuarit me interesin potencial të saj në të ardhmen, ndërsa Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ajo i shërben interesit publik dhe pretendimet e kërkuarit se brenda sipërfaqes ku ndodhej pasuria e tij ishin lejuar të kryheshin ndërtime nuk mund të merreshin në konsideratë prej saj.

26. Në vlerësim të konceptit kushtetues të interesit publik në këndvështrim të vendimeve të kundërshtuara të gjykatave të zakonshme, Gjykata çmon të sjellë në vëmendje qasjen e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) lidhur me standardet e kërkuara nga neni 1, i Protokollit nr. 1, të KEDNJ-së. Kështu, në drejtim të vlerësimit prej saj të ligjshmërisë së ndërhyrjes në të drejtën e pronës private, GJEDNJ-ja ka theksuar se, pikë së pari, është detyrë e gjykatave kombëtare të interpretojnë e zbatojnë legjislacionin vendas dhe të vendosin për çështje të kushtetutshmërisë. Në drejtim të interesit publik, sipas saj, ndërhyrja në përdorimin e pronës private mund të justifikohet vetëm nëse arrihet të provohet, ndër të tjera, se është në përputhje me interesin e përgjithshëm. Nocionet e interesit “publik” dhe “të përgjithshëm” janë të gjera dhe mund të vlerësohen më mirë nga autoritetet vendase. Ndërhyrja në të drejtën e pronësisë kërkon vendosjen e një balance mes interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe detyrimit për mbrojtjen e të drejtave themelore. Në përcaktimin e kësaj balance duhet parë përtej aparençës, duke hetuar realitetin e situatës së kundërshtuar (*shih vendimin e GJEDNJ-së për çështjen Kasmi kundër Shqipërisë, nr. 1175/06, datë 23.6.2020,*



§§ 73, 75). Po sipas GJEDNJ-së, realizimi i planeve rregulluese shtetërore ose vendore duhet kryer brenda një të ardhmeje të afërt dhe shteti nuk mund të justifikojë kufizimin e së drejtës së pronës me pretendimin e realizimit të planit në të ardhmen. Një situatë e tillë tregon mungesë të vëmendjes së nevojshme në baraspeshimin e interesave të pronarëve përkundrejt nevojave planifikuese të bashkisë (*shih vendimin e GJEDNJ-së për çështjen Skibiński kundër Pololisë, nr. 52589/99, datë 14.11.2006, § 88*).

27. Në këndvështrim të sa më lart, në analizë kushtetuese të fakteve dhe rrethanave të çështjes konkrete, pretendimeve të parashtruara në gjykim nga palët, si dhe përmbajtjes së dispozitave kushtetuese që parashikojnë të drejtën e pronës, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit, duke vlerësuar se në të ai ka ngritur të njëjtat pretendime të ngritura në gjykatën e shkallës së parë, për të cilat ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykata e apelit (*shih vendimin nr. 00-2022-2177, datë 5.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, datë 5.10.2022, faqja 9, paragrafi 14*).

28. Në vlerësimin e Gjykatës nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë analizuar ose vlerësuar pretendimet për cenimin e parimit të proporcionalitetit në ndërhyrjen në të drejtën e pronës, pavarësisht se janë ngritur nga kërkuari gjatë procesit gjyqësor ose të ketë arsyetuar për balancën që duhet të ekzistojë mes interesit publik dhe ndërhyrjes në të drejtën kushtetuese të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1, i Protokollit nr. 1, të KEDNJ-së. Kolegji Civil i kësaj gjykate e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit dhe nuk ka argumentuar për pretendimin thelbësor të kërkuarit që lidhet drejtpërsëdrejti me funksionin kushtetues të Gjykatës së Lartë për interpretimin e ligjit nr. 9235/2004 në raport me interesin publik që mbart prona e tij, për të cilën pretendon kthimin fizik dhe jo kompensimin, si dhe VKM-të nr. 366/2008 e nr. 421/2010, si akte nënligjore që e kanë përcaktuar atë si pronë për interes publik. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se arsyetimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në rastin konkret, është i pamjaftueshëm dhe nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me të drejtën e pronës.

29. Gjykata rithekson se funksioni i saj është kontrolli i zbatimit të standardeve kushtetuese dhe

jo ai i një gjykate të zakonshme. Në rastin e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit. Kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Për sa më lart, në këndvështrim të kësaj analize, Gjykata thekson se pretendimet e kërkuarit me natyrë kushtetuese janë të tilla që kërkojnë trajtim në themel në seancë gjyqësore nga Gjykata e Lartë, me qëllim të vlerësimit të çështjes në drejtim të kriterit të proporcionalitetit në kufizimin e së drejtës së pronës për interes publik, sipas neneve 41, pika 3, dhe 17 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën e kërkuarit për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit në lidhje me të drejtën e pronës, ndaj i vlerëson pretendimet e tij të bazuara.

31. Në përfundim, Gjykata çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuarit, sipas arsyetimit të mësipërm, është i bazuar, ndaj duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2177, datë 5.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.



3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.10.2023.

Shpallur më 17.11.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Sandër Beci, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini

Anëtarë kundër: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuarit Muhamet Trepçi, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimeve nr. 569, datë 25.2.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2022-2177, datë 5.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajftueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashitrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Nga rrethanat e çështjes rezulton se në datën 14.10.2008, kërkuari i është drejtuar Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Shkodër me kërkesë për njohjen e së drejtës së pronësisë për një sipërfaqe truall dhe kthimin e kësaj prone të paluajtshme, në cilësinë e njërit prej trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar. Pas trajtimit të kërkesës nga AKKP-ja, kjo e fundit, me vendimin nr. 1301, datë 18.11.2011, ka vendosur njohjen e së drejtës së pronësisë të kërkuarit, si dhe të së drejtës së kompensimit për të, duke vlerësuar se prona nuk mund t’u kthehej trashëgimtarëve, pasi përfshihej në zonën e gjelbër të qytetit dhe ishte regjistruar në inventarin e pasurive të Bashkisë Shkodër e, si e tillë, shfaqte rëndësi të veçantë publike në referim të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 9235/2004. Vendimi i AKKP-së është kundërshtuar gjyqësisht nga kërkuari dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1483, datë 18.2.2013, ka vendosur anulimin e tij. Gjykata e Apelit Tiranë, mbi ankimin e AKKP-së, me

vendimin nr. 569, datë 25.2.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë. Rekursi i kërkuarit nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2177, datë 5.10.2022, e cila ka vlerësuar se ai kishte marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykata e apelit për pretendimet e tij.

3. Në këto kushte, kërkuari ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke pretenduar se Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspekt të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, së drejtës së pronës, si dhe parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, të garantuar nga nenet 42, 41 dhe 18 të Kushtetutës.

4. Shumica, duke pasur parasysh se pretendimet e kërkuarit, në thelb, lidheshin me njohjen e së drejtës së tij për kthimin e pronës private, ka çmuar t’i analizojë ato në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me të drejtën e pronës (*shih paragrafin 14 të vendimit*). Në vijim, ajo ka vlerësuar të trajtojë nëse kriteret e nenit 41 të Kushtetutës, garantimi i pronës private dhe shpërblimi i drejtë, janë vlerësuar e zbatuar drejt në vendimet e gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë, konkretisht nëse ato kanë analizuar dhe vlerësuar kuadrin ligjor që ka përcaktuar ndërhyrjen në të drejtën e tij të pronës, ekzistencën e interesit publik për përdorimin e pronës si hapësirë publike të tillë që justifikon ndërhyrjen në këtë të drejtë, si dhe nëse mes këtij interesi e së drejtës së kërkuarit për pronën private është vendosur balanca e drejtë dhe ndërhyrja ka qenë proporcionale (*shih paragrafin 20 të vendimit*).

5. Më tej, shumica ka vlerësuar se Gjykata e Lartë nuk ka analizuar ose vlerësuar pretendimet për cenimin e parimit të proporcionalitetit në ndërhyrjen në të drejtën e pronës, pavarësisht se janë ngritur nga kërkuari gjatë procesit gjyqësor, dhe nuk ka arsyetuar për balancën që duhet të ekzistojë mes interesit publik dhe ndërhyrjes në të drejtën kushtetuese të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Sipas saj, ajo gjykatë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit dhe nuk ka argumentuar për pretendimin thelbësor të kërkuarit për interpretimin e ligjit nr. 9235/2004 në raport me interesin publik që mbart prona e tij, për të cilën pretendon kthimin fizik dhe jo kompensimin, si dhe të VKM-ve nr. 366/2008 e nr. 421/2010, si akte nënligjore që e kanë përcaktuar atë si pronë për interes publik. Për rrjedhojë, sipas shumicës, arsyetimi i Gjykatës së Lartë është i



pamjaftueshëm dhe nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese në drejtëm të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor në lidhje me të drejtën e pronës e për pasojë vendimi i saj duhet shfuqizuar dhe kërkesa duhet pranuar (*shih paragrafët 28 dhe 30 të vendimit*).

6. Nuk pajtohem me këtë vlerësim të shumicës, pasi çmojmë se vendimet e kundërshtuara, përfshi atë të Gjykatës së Lartë, përmbushin kriteret kushtetuese për standardin e arsytimit të vendimit. Fillimisht, vëmë në dukje se, ashtu siç pohon shumica, e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Me arsyetimin, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive (*shih vendimin nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 10, datë 4.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor, por se ai është tregues i faktit se kërkuesi nuk ka ngritur asnjë nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimin nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 14, datë 21.6.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në rastin konkret ka rezultuar se në çdo fazë të procesit të nisur nga kërkuesi, organi administrativ, megjithëse ka njohur të drejtën e pronës, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij për kthimin e saj, pasi ajo ishte e regjistruar si pasuri e bashkisë e destinuar për t'u kthyer në lulishte dhe në referim të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 9235/2004, sipas të cilit pronat të cilat i shërbejnë një interesi publik nuk mund të kthehen, ai kishte vetëm të drejtën e kompensimit në një nga format e parashikuara nga neni 11 i këtij ligji. Vendimarrja administrative është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe, konkretisht, gjykata e shkallës së parë, pavarësisht se ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, ka vlerësuar se prona e kërkuarit ishte në fazën e pritjes për t'i kaluar bashkisë në përdorim ose pronësi, me fushë përdorimi lulishte dhe rrugë,

dhe potencialisht mund t'i shërbente një interesi publik, ndërsa gjykata e apelit ka vlerësuar se sipërfaqja e pasurisë së kërkuarit ishte në fazën e pritjes së miratimit të listës së pronave të kërkuara për t'u regjistruar në përdorim ose pronësi të bashkisë dhe se organet shtetërore kishin kryer hetime të plota në këtë drejtëm, duke vlerësuar gjendjen e pronës në terren. Kjo do të thotë se gjykatat e faktit kanë analizuar dhe arsyetuar për të drejtën e kërkuarit për kthimin e pronës, pra në lidhje me verifikimin e kushteve ligjore për kthimin dhe kompensimin e pronës sipas ligjit nr. 9235/2004. Gjithashtu, gjykatat kanë vlerësuar për ekzistencën e interesit publik për përdorimin e pronës si hapësirë publike, të tillë që justifikon ndërhyrjen në këtë të drejtë, pra që lulishtja përbente interes publik, ndaj prona nuk mund të kthehej, ndërsa kërkuesi nuk ka pasur ndonjë pretendim për antikushtetutshmërinë e ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës, për sa i takon çështjes së moskthimit të pronës për këtë shkak.

8. Në këtë pikë duhet evidentuar se organi administrativ dhe gjykatat kanë vepruar në zbatim të ligjit nr. 9235/2004, sipas të cilit pronat të cilat i shërbejnë një interesi publik nuk mund të kthehen. Kjo do të thotë se ligjvënësi, ashtu siç është pranuar në jurisprudencën kushtetuese (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*), brenda hapësirës së tij normuese, ka vepruar duke përcaktuar në këto raste qëllimin që kërkon të arrijë dhe duke e identifikuar këtë çështje si interes publik. Me fjalë të tjera, organi administrativ dhe gjykatat nuk mund të shmangeshin nga koncepti kushtetues i interesit publik i përcaktuar nga ligjvënësi, për sa kohë kushtetutshmëria e ligjit nuk është vënë në dyshim.

9. Koncepti kushtetues i interesit publik, ashtu siç është trajtuar në praktikë të vazhdueshme nga Gjykata, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e aktit konkret që paraqitet për kontroll para saj. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyen publike që çojnë në kufizimin e një të drejte themelore, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë



brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë.

10. Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, konstatohet se ajo është vënë në lëvizje nga kërkuesi, i cili ka pretenduar se gjykata e apelit ka gabuar në arsyetimin e saj, pasi sipërfaqja e tokës nuk ka qenë as në pronësi, as në përdorim të bashkisë, pra potencialisht i shërbente interesit publik. Gjykata e Lartë, brenda funksionit të saj, ka vlerësuar se nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë nuk ka pasur shkelje procedurale, të cilat mund të ndikojnë në dhënien e vendimit dhe se kjo gjykatë ka respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit procedural dhe atij material; palëve u është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë në lidhje me to dhe të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, në respektim të të gjitha parimeve bazë të zhvillimit të procesit të rregullt ligjor (*shih paragrafët 12–13.5 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Gjithashtu, megjithëse me një arsyetim të kufizuar, Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje shkaqeve të rekursit, duke arritur në përfundimin se nuk ekzistojnë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Për më tepër, Gjykata e Lartë është ndalur dhe i ka kthyer përgjigje pretendimit të kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit në lidhje me të drejtën e pronës, pasi e ka konsideruar këtë pretendim si të natyrës kushtetuese, duke arritur në përfundimin se ai bazohej në premisën e respektimit të barazisë në shkeljen e interesit publik, çka nuk mund të ishte e pranueshme në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës. Sipas asaj gjykate, kufizimi i së drejtës së pronësisë së kërkuesit parashikohej nga ligji, ishte bërë për shkak të mbrojtjes së interesit publik dhe nuk mund të konsiderohej se cenonte thelbin e kësaj të drejte në kuptim të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, si dhe neneve 17 dhe 41, të Kushtetutës (*shih paragrafin 14, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

11. Në vështrim të sa më sipër, evidentojmë se gjykata e apelit ka përcaktuar faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në vendimarrjen e saj, ndërsa Gjykata e Lartë ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme se kjo vendimarrje ka qenë e drejtë dhe rekursi nuk përmbante shkaqet e parashikuara

nga ligji. Gjykata e apelit e ka arsyetuar në mënyrë të detajuar interesin publik si kriter që justifikon kufizimin e së drejtës së pronës private, duke dhënë mjaftueshëm argumente lidhur me pretendimin e kërkuesit në drejtim të cenimit të kësaj të drejte dhe të parimit të barazisë përpara ligjit e mosdiskriminimit. Në këtë mënyrë, kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar, ndërsa Gjykata e Lartë ka ushtruar plotësisht dhe në mënyrë korrekte funksionin e saj si gjykatë e ligjit.

12. Nga ana tjetër, ne gjyqtaret në pakicë vlerësojmë se nuk është detyrë e Gjykatës të analizojë provat dhe faktet ku janë bazuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen në themel të çështjes së kërkuesit, pasi kjo mbetet detyrë funksionale e atyre gjykatave. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, gjë e cila në rastin konkret rezulton të jetë përmbushur si nga gjykata e apelit, ashtu edhe nga Gjykata e Lartë. Fakti se rekursi i kërkuesit është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, nuk do të thotë se ajo gjykatë ka kryer vetëm një konstatim formal të paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por se ka kryer edhe vlerësimin e shkaqeve dhe bazueshmërinë e tyre në themel, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rastin konkret, Kolegji Civil në dhomën e këshillimit ka krijuar bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuesi kanë qenë të pabazuara në dispozitat përkatëse ligjore e, si të tilla, ato nuk mund të pranoheshin, duke vendosur përfundimisht mospranimin e rekursit. Në këtë drejtim, ritheksojmë se vlerësimi kushtetues i Gjykatës nuk mund të zëvendësojë prerogativat/rolin/ funksionin e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke e kthyer atë në një shkallë të katër gjykimi.

13. Në përfundim, ne gjyqtaret në pakicë çmojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, për rrjedhojë edhe ai për të drejtën e pronës, është i pabazuar, prandaj duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës.

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë